

VENDIM
Nr. 6, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME
DURRËS SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.’”,

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a., me shkresën nr. 554 prot. datë 30.1.2022, me lëndë “Kërkesë për pajisje me licencë” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Durrës sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. (NUIS M22031502M) është themeluar më datë 13.7.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë: Durrës me 32.47%, Shijak me 2.43%, Rrogozhinë me 2.16%, Krujë me 3.45%, Kavajë me 8.49%;

b) shoqëria rajonale UK Durrës sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 472,148 banorë të bashkive: Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Krujë, Kavajë;

c) drejtues teknik i shoqërisë z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me master shkencor në “Hidroteknikë”, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

d) drejtues teknik i shoqërisë z. Bledar Metalla është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me master shkencor në “Hidroteknikë”, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Durrës sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Durrës sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. me (NUIS M22031502M), në kategoritë:

- a) kategoria A: “Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik”;
- b) kategoria B: “Për përpunimin e ujit për konsumim publik”;
- c) kategoria C: “Për largimin e ujërave të ndotura”;
- d) kategoria D: “Për përpunimin e ujërave të ndotura”.

2. Shoqëria rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) drejtues ligjor: Spartak Kovaçi;
- b) drejtues teknik: Gerald Dautaj;
- c) drejtues teknik: Bledar Metalla.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. janë bashkitë: Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Krujë, Kavajë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 344, datë 23.9.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Durrës sh.a.”, shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 272, datë 30.3.2021, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Krujë sh.a.”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani